



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-CC-PR-2017-03

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 7 qershor 2017

Titulli: Referimi i Rregullave të Rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe të Provave sipas nenit 19(5) të Ligjit

Publik

Vendim në lidhje me vendin e zhvillimit të procedurës së Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e Rregullave të Rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe të Provave sipas nenit 19(5) të Ligjit

Autoriteti kërkues:

Kryetarja e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), pasi ka marrë kërkesën e Kryetares së Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese (“DHSGJK”) për ndryshimin e vendit të zhvillimit të procedurës në shtetin pranues, me anë të këtij vendimi dhe në përputhje me nenin 3(8)(d) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), cakton vendin e zhvillimit të procedurës së DHSGJK-së për shqyrtimin e Rregullave të Rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullat e Rishikuara”) sipas nenit 19(5) të Ligjit.

1. Pas Aktvendimit të DHSGJK-së “mbi Referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar” të datës 26 prill 2017, gjykatësit e Dhomave të Specializuara të mbledhur në seancë plenare (“Plenarja”), me përjashtim të gjykatësve të DHSGJK-së, miratuan Rregullat e Rishikuara më 29 maj 2017.

2. Më 31 maj 2017, Kryetarja, duke vepruar në përputhje me nenin 19(5) të Ligjit, i referoi DHSGJK-së Rregullat e Rishikuara të miratuara nga Plenarja.¹ Në të njëjtën ditë, në përputhje me nenin 33(3) të Ligjit, Kryetarja caktoi një panel të Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e Rregullave të Rishikuara, me qëllim garantimin e përputhshmërisë së tyre me Kapitullin II të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.²

3. Më 2 qershor 2017, duke vepruar në bazë të nenit 3(8)(c) të Ligjit, Kryetarja e DHSGJK-së bëri kërkesë për ndryshimin e vendit të zhvillimit të procedurës në lidhje me Referimin e Rregullave të Rishikuara, në shtetin pranues.³

¹ Referim i Rregullores së Procedurës dhe të Provave, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, Nr. KSC-CC-PR-2017-03, 31 maj 2017.

² Vendim për caktimin e gjykatësve në një panel të Gjykatës Kushtetuese të Dhomave të Specializuara, Nr. KSC-CC-PR-2017-03, 31 maj 2017.

³ Kërkesë për ndryshimin e vendit të zhvillimit të procedurës në lidhje me Referimin e Rregullave të Rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe të Provave sipas nenit 19(5) të Ligjit, Nr. KSC-CC-PR-2017-03, 2 qershor 2017.

4. Ligji përkatës në lidhje me këtë kërkesë është siç është parashtruar më herët.⁴

PËR KËTO ARSYE, DHE NË ZBATIM TË NENIT 3(8)(D) TË LIGJIT, KRYETARJA NË VIJIM

cakton vendin e zhvillimit të procedurës së Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e Rregullave të Rishikuara sipas nenit 19(5) të Ligjit, në shtetin pranues, në mënyrë që Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese të mblidhet, të shqyrtojë, të marrë dhe të nxjerrë dorëzime e parashtrime, në selinë e Dhomës së Specializuar në shtetin pranues; dhe

kërkon nga Administratorja që të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për zbatimin e këtij vendimi.

/nënshkrim/

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,
Kryetare

E mërkurë, 7 qershor 2017

Në Hagë, Holandë.

⁴ *Krahaso* Vendim për vendin e zhvillimit të procedurës së Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave sipas nenit 19(5) të Ligjit, Nr. KSC-CC-PR-2017-02, 12 prill 2017, paragrafët 6-9.